



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Shërbim organizimi i ceremonisë së diplomimit të studentëve”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): Shërbime të organizimit të eventeve - 79952000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: **3,275,000** (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) **Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban*

vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kjo shtojce është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituara.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe në këto rregulla.”

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 2/c, neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Si dhe neni 55/4.....” Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për

realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së zhvillimit të aktivitetit, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të siguruar / me kontratë me kërkesat minimale si më poshtë:

a. Të paktën 1 (një) drejtor artistik / skenograf me eksperiencë pune i cili të ketë mbaruar shkollën e lartë në një nga degët e skenografisë ose arteve, ku kjo të vërtetohet me diplomë/dëshmi/certifikatë/CV/çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tij/e saj;

- b. Të paktën 1 (një) dizenjues grafik me eksperiencë pune i cili të ketë mbaruar shkollën e lartë në degën e Arteve Grafike/ Art dhe Design, ku kjo të vërtetohet me diplomë/dëshmi/certifikatë/CV/çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tij/e saj;
- c. Të paktën 1 (një) koordinator eventesh me eksperiencë pune në organizimin e eventeve;
- d. Të paktën 2 (dy) asistentë koordinator eventesh me eksperiencë pune në organizimin e eventeve.

Për të vërtetuar këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë Pune të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës;
- CV;
- Diplomë / dëshmi / certifikatë për drejtorin artistik / skenografin dhe dizenjuesin grafik;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik / profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi për punonjësit e siguruar nga operatori ekonomik.

2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së zhvillimit të aktivitetit, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf mbështetës të siguruar / me kontratë, me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) videograf me eksperiencë pune;
- Të paktën 1 (një) teknik led me eksperiencë pune;
- Të paktën 1 (një) teknik fonie me eksperiencë pune;
- Të paktën 2 (dy) fotograf me eksperiencë pune;
- Të paktën 1 (një) kameramanë me eksperiencë pune.

Për të vërtetuar këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë Pune të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës;
- CV;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik / profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi për punonjësit e siguruar nga operatori ekonomik.

Kriteri 2.3.2 dhe 2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.2. a: 1 (një) drejtor artistik / skenograf me eksperiencë pune i cili të ketë mbaruar shkollën e lartë në një nga degët e skenografisë ose arteve, ku kjo të vërtetohet me diplomë/dëshmi/certifikatë/CV/çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tij/e saj, i cili do të merret me përcaktimin e skenografisë së eventit, duke filluar nga pozicionimi i ekraneve led wall, banerave, ndriçimi dhe detajeve të tjera teknike.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.2. b: Të paktën 1 (një) dizenjues grafik me eksperiencë pune i cili të ketë mbaruar shkollën e lartë në degën e Arteve Grafike / Art dhe Design, ku kjo të vërtetohet me diplomë/dëshmi/certifikatë/CV/çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tij/e saj, i cili do të merret me dizenjimin e banerave dhe materialeve që do të shfaqen në led wall.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.2. c: Të paktën 1 (një) koordinator eventesh me eksperiencë pune në organizimin e eventeve, i cili do të merret me organizimin dhe menaxhmin e të gjitha detajeve teknike dhe organizative të eventit.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.2. d: Të paktën 2 (dy) asistentë koordinator eventesh me eksperiencë pune në organizimin e eventeve, të cilët do të asistojnë koordinatorin e eventeve në lidhje me organizimin dhe menaxhmin e të gjitha detajeve teknike dhe organizative të eventit.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.3.: Të paktën 1 (një) videograf me eksperiencë pune, i cili bazuar në specifikimet teknike do të realizojë klipin promocional 2-3 minuta.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.3.: Të paktën 1 (një) teknik led me eksperiencë pune, i cili bazuar në specifikimet teknike do të realizojë montimin e led walleve në skenë.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.3.: Të paktën 1 (një) teknik fonie me eksperiencë pune, i cili bazuar në specifikimet teknike do të realizojë montimin dhe menaxhimin e sistemit të fonisë gjatë gjithë eventit.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.3.: Të paktën 2 (dy) fotograf me eksperiencë pune, të cilët bazuar në specifikimet teknike do të kujdesen për të fotografuar të gjithë momentet kryesore të eventit.

Argumentimi për kërkesën sipas pikës 2.3.3.: Të paktën 1 (një) kameramanë me eksperiencë pune, i cili bazuar në specifikimet teknike do të kujdesen për të xhiruar të gjithë eventin dhe për montazhin e tij.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se projekti në vetëvete është një projekt TIK, nisur nga termat e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar/ certifikuar në degët/ fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenin 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit si dhe bazuar në shkresën shkresën e Drejtorisë së Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit Nr. 1072 Prot., datë 09.04.2024 me lëndë “Mbi organizimin e ceremonisë së diplomimit” si dhe relacionin Nr. 1072/1 Prot., datë 18.04.2024 “Mbi zbatimin e Vendimit të Rektoratit të Universitetit

të Mjekësisë, Tiranë me Nr. 4, datë 08.04.2024 “Për organizimin e ceremonisë së diplomimit për studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, shkresa me specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shërbimi që kërkohet:

| ORGANIZIMI I CEREMONISË SË DIPLOMIMIT TË STUDENTËVE | | | |
|---|---|--------------|---------------|
| NR. | EMËRTIMI | SASIA | NJËSIA |
| Aktiviteti do të zhvillohet në Pallatin e Kongreseve, salla kryesore + holli kryesor për pritje catering | | | |
| 1 | DIZAJN DHE SKENOGRAFI | | |
| | Dizajn banner në hyrje 10x3m | 1 | copë |
| | Dizajn ftesa 15x12 cm | 1 | copë |
| | Dizajn diplome A4 | 1 | copë |
| | Dizajn adeziv shtrim në tokë në hyrje 70m2 | 1 | copë |
| | Dizajn baner backdrop 9x2.5 m | 4 | copë |
| 2 | PRINTIME DHE PRODHIME SKENOGRAFI | | |
| | Foltore me logo | 1 | copë |
| | Prodhim baner backdrop 9x2.5 m, 4 copë | 90 | m2 |
| | Prodhim banner në hyrje 10x3m | 30 | m2 |
| | Prodhim ftesa 15x12cm, 4 kolor, letër 300 gr, matt, print në 2 anë, plastifikim mat | 100 | copë |
| | Prodhim zarfa katror 16x 13 cm, Me printim letër me shkëlqim me prerje me formë dhe ngjitje | 100 | copë |
| | Prodhim Diplome, Letër 300 gr, A4 | 1300 | copë |
| | Veshje e pjesës së skenës me tapet përfshi montim dhe transportin | 250 | m2 |
| | Printim adeziv shtrim në tokë në hyrje 70m2 | 70 | m2 |
| 3 | SISTEM PROJEKTIMI, NDRIÇIMI DHE AUDIO | | 1 |
| | 189W BEAM LIGHT MOVING HEAD (24 copë) | | |
| | 19x40W RGBW LED WASH LIGHT MOVING HEAD (12 copë) | | |
| | BSW 480W CMY DISCHARGE LIGHT MOVING HEAD (12 copë) | | |
| | 18x12W RGBWA LED PAR LIGHT 45' GRAD (60 copë) | | |
| | THEATER SPOT FRESNEL 1000W (24 copë) | | |
| | POWER DIMMER 12CH (2 copë) | | |
| | AUDIENCE BLINDERS 2X100W (16 copë) | | |

| | | | |
|---|--|----|---------|
| | LIGHTING CONSOLE (1 copë) | | |
| | DMX/RDM SPLITTER 6 OUT (4 copë) | | |
| | HAZE EFFECTS + HAZE FUN (2 copë) | | |
| PA-Main | | | |
| | MAIN SYSTEM LINE ARRAY 3 WAY PASSIVE HIGH POWER LONG THROW (16 copë) | | |
| | HI POWER SUBWOOFER 2X18 6400W (8 copë) | | |
| | RACK AMPLIFIKIMI PER SISTEMIN LINE ARRAY & SUBWOOFERS (2 copë) | | |
| | DIGITAL STAGEBOX 32IN 16OUT (1 copë) | | |
| | Digital MIXING Console 72CH (1 copë) | | |
| | MONITOR PER STAGE 15" COAXIAL (4 copë) | | |
| | SISTEM LINE ARRAY PER RRESHTAT E PARE (6 copë) | | |
| | BOKSE TE AMPLIFIKUAR 12" 1500W (4 copë) | | |
| | SUBWOOFER TE AMPLIFIKUAR 18" 2000W (4 copë) | | |
| MICS & UHF | | | |
| | TAVOLINE DJ TIP Z-TABLE (2 copë) | | |
| | MIKROFONA WIRELESS ME ANTENA DIREKSIONALE (4 copë) | | |
| | MIKROFONA WIRELESS HEAD SET CARDIOIN CAPSULE (2 copë) | | |
| | MIKROFONA PER FOLTOR TIP SHOTGUN (2 copë) | | |
| STRUKTURA DHE VARJA E SISTEMEVE | | | |
| | TRAVERSA ALUMINI 30X30 SEKSIONE 2M (25 copë) | | |
| | VINXHA ELEKTRIK 1 TON (12 copë) | | |
| | PULTE KOMANDIMI PER VINXHAT (6 copë) | | |
| SISTEMI ELEKTRIK DHE SHPËRNDARJA | | | |
| | POWER DISTRO IN 64A Out 2 x 32 A , 12 x 2P+T 16A (2 copë) | | |
| | POWER DISTRO IN 32A OUT 6 X 2P+T 16A (4 copë) | | |
| | MAIN POWER CABLES 64 A 5X25 40M (2 copë) | | |
| | DISTRIBUTION CABLES 32A 5X10 25M (4 copë) | | |
| | DISTRIBUTION CABLES 16A 3X2.5 10M 2P+T (30 copë) | | |
| | DISTRIBUTION CABLES 16A 3X2.5 10M SHUCKO STANDARD (30 copë) | | |
| | CROSS CABLE 1M (20 copë) | | |
| LED WALL & VIDEO | | | |
| | LED WALL P8 6X10M QENDROR (60 m2) | | |
| | LED WALL P3.9 3X4M X 2 ANESOR (24 m2) | | |
| | PC PLAYOUT VIDEO (2 copë) | | |
| | VIDEO PROCESOR (3 copë) | | |
| | HDMI EXTENDER HDMI-LAN-HDMI (2 copë) | | |
| 4 | EFEKTE SKENIKE CONFETTI ME BOMBULA CO2 | 2 | copë |
| 5 | FISHEKZJARRE SPARKLE ME PLUHUR TITANI | 12 | copë |
| 6 | VAJZA HOSTESS | 2 | Persona |

| | | | |
|-----------|---|------|------------|
| 7 | KOKTEIL KATERING | | |
| | Shampanjë, 2 tipe ëmbëlsirash, logjistikë, transport etj | 1000 | Persona |
| 8 | GRAFIKA PËR NË LED WALL / DIZENJIME | 4 | Video/Foto |
| | Klip promocional 2-3 minuta | | |
| | Dizenjime të ndryshme gjatë ceremonisë | | |
| 9 | DJ PËR MUZIKË PËR TË GJITHË EVENTIN | 1 | Person |
| 10 | LOOP LOGO NË SFOND | | |
| | Të animuar për interlacimin e figurës në mënyrë që planet të rezultojnë të plota. Në FormatHd 1920x1080 | 1 | Video |
| 11 | FOTO DHE VIDEO MONTAZH | 1 | Set |
| | Xhirim eventit me 3 kamera HD, dhe do montohet me regji televizive | | |
| | Në sfond do të ketë montazhe të fotove (të eventeve të kaluara) | | |
| | Realizim i një montazhi të gjatë dhe një klip të shkurtër përmbledhës. | | |
| | Paisjet e kërkuara | | |
| | Camera AG-HPX-37 1 P2 | | |
| | Camera Pmw-500. 18x76 and 12x4.5 | | |
| | Lens 1/3 Bayonet Mount (17 + optical) | | |
| | Lens 1/3 Bayonet Mount (4.5) | | |
| | Super fisheye lens 82+33 | | |
| | 7 HD-SDI monitor | | |
| | Portable Editing System laptop, with adobe Premiere Pro CS 5 | | |
| | Vegas 12, Editing Software | | |
| | 2 Fotografë | | |
| | Kameramanë të specializuar ne live events e Studio Shootings | | |
| | Ndricim suplementar për ndricimin e planeve të xhirit | | |
| | Realizim skenari | | |
| 12 | KOORDINATOR EVENTI | 1 | Person |
| 13 | ASISTENT EVENTI | 2 | Person |
| 14 | MODERATOR EVENTI | 1 | Person |

Afatet e ekzekutimit:

- Brenda 10 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës.

Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është organizimi i ceremonisë së diplomimit të studentëve të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

NJËSIA E PROKURIMIT: